



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË DSHB PËR PERIUdhËN JANAR –
SHTATOR TË VITIT 2021**

Departamenti shëndetësor i burgjeve, bazuar në planin e punës për vitin 2021, buxhetin e aprovuar, stafin që posedon, përpjekjet për zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimit, Menaxhimin e pandemisë në burgje konform Rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe Masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Manualit të MSh-së dhe masave kundër epidemike të DShB-së, ka kryer aktivitet e parapara sipas planit të punës dhe situatës epidemiologjike në vend.

Në të njëjtën kohë janë kryer edhe aktivitete e planifikuara sipas planit të punës dhe gjendjes shëndetësore epidemiologjike.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur indikatorët që përcaktojnë aktivitete kryesore shëndetësore në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve – DShB:

Tabela numër 1, përmbledhje (9) nëntëmujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Të dhënat mbi disa indikatorë të DShB, Janra -Shtator, 2021		Muajtë									Totali
Nr	Indikator	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	
1	Te burgosur te pranuar	361	346	484	416	335	457	416	335	457	3607
2	Te burgosur te liruar	272	191	262	314	243	292	314	243	292	2423
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	361	350	484	416	335	457	416	335	457	3611
4	Konsulta mjekesore	2841	2192	2833	2456	2240	2434	2456	2240	2434	22126
5	Konsulta psikiatrike	473	486	521	443	396	514	443	396	514	4186
6	Konsulta psikologjike	407	477	565	522	464	470	522	464	470	4361
7	Sherbime dentare	191	186	245	212	191	182	212	191	182	1792
8	Sherbime te tjera mjekesore	1374	1336	1953	1564	1553	1772	1564	1553	1772	14441
9	Totali i konsultimeve shendetesore	4821	4140	5419	4582	4456	5086	4582	4456	5086	42628
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	8	7	9	8	14	14	8	14	14	96
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	19	11	14	14	14	15	14	14	15	130
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	145	134	167	133	171	239	133	171	239	1532
13	Dergimet jashte IK per intervenime	11	20	26	25	14	16	25	14	16	167
14	Transferet shendetesore	12	13	18	12	3	1	12	3	1	75
15	Rastet me TBC	0	0	0	0	2	0	0	2	0	4
16	Rastet me HEPATIT B	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
17	Rastet me HEPATIT C	0	0	0	2	0	1	2	0	1	6
18	Rastet HIV pozitiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	151	120	151	139	127	142	139	127	142	1238
20	Analizat e gjakut sipas planit	33	3	80	60	7	25	60	7	25	300
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	23	39	27	25	46	62	25	46	62	355
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	0	22	0	0	0	0	0	0	22
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1207	1274	1260	1361	1259	1361	1361	1259	1361	11703
24	Kontrollet stomatologjike sistematike	3	12	4	0	10	0	0	10	0	39
25	Kontrollet gjinekologjike sistematike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
26	Mamografi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
27	PAPA test	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
28	RTG Pulmo	14	13	16	12	11	9	12	11	9	107
29	Neurotic Syndromes	240	185	223	210	218	193	210	218	193	1890
30	Psychotic Syndromes	25	40	40	44	36	48	44	36	48	361
31	Semundjet kardiovaskulare	61	79	71	75	78	88	75	78	88	693
32	Semundjet Respiratore	140	106	213	153	131	116	153	131	116	1259
33	Semundjet gastrointestinale	151	107	133	122	128	131	122	128	131	1153
34	Semundjet urogenitale	41	43	48	61	50	55	61	50	55	464
35	Semundjet e lekures	82	79	92	93	78	91	93	78	91	777
36	SS te transmetueshme	1	0	1	0	0	0	0	0	0	2
37	Semundjet e sistemit lokomotor	122	119	123	105	110	135	105	110	135	1064
38	Semundjet infektive	1	2	4	3	3	1	3	3	1	21
39	Vete lendimet	16	4	9	2	7	16	2	7	16	79
40	Lendimet trupore	17	33	21	27	24	19	27	24	19	211
41	Abuzimet seksuale	0	1	0	0	2	0	0	2	0	5
42	Rastet ne greve te urise	7	4	0	8	9	9	8	9	9	63
43	Tentim vetevrasjet	1	2	0	3	2	2	3	2	2	17
44	Vetmia - Izolimi	62	62	60	30	31	15	30	31	15	336
45	Vdekjet ne burg	0	1	1	2	0	0	2	0	0	6

Bazuar në këto të dhëna, gjatë kësaj periudhë ka pasur 42628 vizita mjekësore, 11703 vizita sistematike, 4677 analiza laboratorike, 1238 aplikime te testeve psikologjike, 96 hospitalizime ne stacionar të burgut dhe 130 hospitalizime në institucione të tjera.

Sa i takon indikatorëve të sjelljeve jo të shëndetshëm, të paraqitur ne tabelën numër 2 vërejmë se kemi rritje të numrit të përdoruesve të duhanit në 69%, drogave në 14.19% dhe një numër i konsiderueshëm i të sëmurëve me diabet, hipertension dhe katër raste të ardhura me TBC në burgje:

Tabela numër 2, përmbledhje (9) nëntëmuajore e disa indikatorëve specifik të DShB;

Raportimi i nëntëmuajorit për disa indikatorëve në burgje për vitin 2021 nga të gjitha NjShB-të, DShB												
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituave për herë të parë	361	346	484	416	335	456	378	392	413	3581	100.00
2	Numri i duhangjinjeve	248	236	330	298	240	325	235	262	297	2471	69.00
3	Numri i abuzuesve të alkoolit	28	27	39	32	29	31	33	27	32	278	7.76
4	Numri i abuzuesve të drogave	67	46	69	63	51	65	48	48	51	508	14.19
5	Rastet me Hepatitis B	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0.03
6	Rastet me Hepatitis C	0	0	1	1	0	1	0	0	2	5	0.14
7	Rastet me lendime trupore	18	28	14	24	19	27	24	38	16	208	5.81
8	Rastet me TBC	0	0	0	0	2	0	2	0	0	4	0.11
9	Rastet me Diabet	6	8	16	11	5	10	5	7	14	82	2.29
10	Rastet me SST (AIDS)	1	0	6	0	0	0	0	0	0	7	0.20
11	Rastet me Hipertension Arterial	12	25	36	31	15	21	16	18	23	197	5.50

Menaxhimi i COVID-19 ka qenë nën kontroll dhe me 103 raste të infektuar, 13 të burgosur, 77 staf korrektues dhe 13 staf shëndetësor.

Tërë kohën ka pasur mjaftueshëm mjete mbrojtëse, barëra dhe material shëndetësor dhe diagnostikues.

Nga ShSKUK kemi pranuar dhe i kemi funksionalizuar 15 Oksigjen formues në të gjitha Njësitë Shëndetësore të Burgjeve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë vaksinimi i stafit shëndetësor, i të burgosurve mbi moshën 65 vjeçare dhe atyre me sëmundje kronike, insuline vartës, sipas planit të Komitetit për Imunizim të MSh-së.

DShB ka bërë përgatitjet e nevojshme duke përpiluar listat e të gjithë të burgosurve dhe stafit korrektues për vaksinim.

Ka bërë trajnimin e 11 ekipeve (një mjek dhe dy infermier) për të qenë të gatshëm për të filluar vaksinimin si dhe për të ndihmuar shëndetin publik në rast nevojë pa e dëmtuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore në burgje.

Ka përgatitë edhe infrastrukturën përkatëse për këto shërbime dhe ka përfunduar mbi 97% të të burgosurve dhe stafit.

Në vazhdimësi është duke bërë edhe vaksinimin e burgosurve që vijnë nga jashtë e që janë të pa vaksinuar.

Si rezultat i kësaj pune, janë vaksinuar 1976 të burgosur, 941 staf, në total 2917 persona me dozë të dytë, ndërsa janë vaksinuar 73 persona me dozë të parë. Procesi i vaksinimit është në vazhdim e sipër.

Tabela numër 3, përmbledhje (9) nëntëmujore e rasteve të vaksinuara kundër COVID-19, në burgje

Raport mbi vaksinimin ne burgje										
Nr	Persona me dozë të dytë			Persona me dozë të parë			Total Persona			Vendi i vaskinimit
	Të burgosur	Staf	Total	Të burgosur	Staf	Total	Të burgosur	Staf	Total	
1	1976	941	2917	71	2	73	2047	943	2990	NjShB

Si pasojë e ardhjes së të burgosurve në vazhdimësi nga jashtë dhe të pa vaksinuar në këtë moment të raportimit janë edhe 188 persona të pa vaksinuar e të cilat në baza dy javore vaksinohen në vazhdimësi. Një numër i vogël janë që nuk dëshirojnë të vaksinohen ose edhe të tillë që rishtas kanë pasur infeksion dhe janë duke pritur periudhën përkatëse të mundshme për vaksinim. Jemi duke punuar në këtë drejtim që gjithë secili të vaksinohet.

Tabela numër 4, përmbledhje (9) nëntëmujore e rasteve të pa vaksinuara kundër COVID-19, në burgje

Numri aktual i të pa vaksinuarve (burgosur, staf korrektues dhe mjekësor) në burgje												
Nr		Burgjet										TOTALI n
		Dubravë	Lipjan 1	Lipjan 2	Gërdovc	mrekovnic	Prishtinë	Gjilan	Prizren	Mitrovicë	Pejë	
1	Staf korrektues	8	4	3	1	0	0	5	2	5	0	28
2	Staf Shëndetësor Te burgosur	0	0	0	0	0	1	2	0	0	0	3
3	(pranime të reja)	39	8	4	17	1	39	30	9	5	5	157
4	Subtotal	47	12	7	18	1	40	37	11	10	5	188

Tabela numër 5, përmbledhje (9) nëntëmujore e shpenzimit të buxhetit në burgje

Buxheti i planifikuar për DShB për Vitin 2021, sipas kategorive, shpenzimet deri me 30.10.2021					
Nr	Kategoria	Buxheti i ndarë për vitin 2021	Shpenzuar deri me 31.10.2021	Perqindja e shpenzimit	Vërejtje
1	Kodi 726; DShB, Buxheti Total	1,622,577.41	1,245,270.46	76.75	
2	NUMRI I STAFIT	125	120	5	5 punëtor e kanë lënë punën, në proces regrutimi I të tjerëve
2	RROGA DHE PAGA	1,142,577.41	891,198.55	78.00	Sipas planit
3	MALLRA DHE SHËRBIME	425,000.00	301,748.66	71.00	Janë në proces poces për shpenzime gjatë periudhës së katërt
4	SHPENZIME KOMUNALE	5,000.00	2,323.25	46.47	Jemi në përpjekje për kursime në komunla
5	PASURITË JO FINANCIARE - KA	50,000.00	50,000.00	100.00	Janë realizuar dhe janë në perfundim projektet

Shpenzimi i buxhetit ka shkuar sipas planit të rrjedhës së parasë dhe atij të prokurimit. Ka pasur disa vonesa nga disa furnizues ndaj të cilëve janë ndërmarrë masat adekuate. Ka pasur vështirësi në sistemin e menaxhimit të financave sa i takon pagave duke qenë se sistemi ka ngecje ne formulë dhe është e pa mundur futja e numrit të stafit pasi që koeficienti nuk është në formulë për staf shëndetësor por vetëm për atë civil. Kemi bërë reagimin tonë më kohë për të satën herë për përmirësim të kësaj çështjeje nga MFT. Nga raporti i Auditorit të përgjithshëm nuk ka pasur asnjë vërejtje për DShB.

Ka përfunduar procesi i tenderimit për pajisjet kapitale, të cilat priten të realizohen deri në përfundim të vitit.

Po ashtu në proces të tenderimit janë edhe servisimet e pajisjeve radiologjike dhe laboratorike. Gjatë tërë kohës kemi pasur mjaftueshëm furnizim me barëra dhe materla shëndetësor për të gjitha njësitë.

Jemi në proces të përfundimit të kompletimit të të gjitha njësive me Ultrazë, Monitor, Defibrilator, Laborator, EKG, Oksigjen formues dhe pajisje të tjera të nevojshme.

Kemi bërë servisimin e të gjitha pajisjeve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar edhe Draft Raportin nga Komiteti për parandalim të Torturës i Këshillit të Evropës. Shumica e Rekomandimeve për DShB-në janë të natyrës teknike dhe të cilat japin avantazh PSV-ve të DShB-së dhe kryesisht rekomandimet janë në funksion të zbatimit të tyre. Ne kemi dhënë përgjigjen dhe kemi ndërmarrë edhe aktivitetet e nevojshme për të plotësuar këto rekomandime.

Kemi dhënë kontributin tonë në MD për plotësim dhe zbatim të disa rekomandimeve tona për draft ligjet dhe strategjitë zhvillimore të MD, sa i takon Ligjit për ShKK dhe atij për ESPK.

Po ashtu në mbështetje të MD jemi në përfundim të zbatimit të projektit për Institucionin për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në Burgun e Dubravës si pjesë e paraparë me Ligjin për Shëndetësi. Është hartuar projekti dhe është në proces të aprovimit të kërkesës nga Qeveria lidhur më shtimin e stafit dhe buxhetit për këtë qëllim.

Në këtë vazhdë janë në proces edhe përpjekjet për zgjerimin e kapaciteteve të Psikiatrisë Ligjore.

Në vazhdimësi kemi bërë monitorimin e NjShB në funksion të zbatimit të PSV-ve, rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, zvogëlimin e tentim vetëvrasjeve dhe vetëlëndimeve dhe dhënien e këshillave për situatat e caktuara.

Jemi në proces të organizmit të gjashtë punëtorive për zbatimin e PSV-ve dhe Rekomandimeve të KPT të KE. Punëtoritë janë të mbështetura nga Projekti KSV017.

Kemi shtuar aktivitetet profesionale dhe ato të shëndetit mendor edhe përmes aktivizimit maksimal të Komisioneve Multi Disiplinore, për të shmangur rreziqet si pasojë e izolimeve dhe formave të tjera të pandemisë. Më poshtë do të paraqesim disa nga aktivitetet e shëndetit mendor për të mbështetur personat në nevojë konform standardeve, strategjisë dhe PSV-ve:

Edhe përkundër zbutjes së masave kundër epidemike shërbimet e shëndetit mendor në burgje edhe në tremujorin e trete të vitit 2021 ka vazhduar me kryerjen e të gjitha shërbimeve me theks të veçantë në masat e shtuar për detektimin dhe menaxhimin e rasteve me rrezik potencial për vetëvrasje apo vetëlëndim.

Shumica e shërbimeve, përfshirë intervistat e para psikologjike, ekzaminimi i statusit mendor, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psikologjike janë ofruar nga psikologët nëpër blloqe, pavijone e hapësira të përshtatura sipas masave për parandalimin e Covid 19. Duke i mbajtur kështu të pa cenueshme të gjitha shërbimet rutinore të shëndetit mendorë.

Pas vendimeve për lehtësimin e masave, sipas kërkesës së drejtorit të DSHB, nga stafi i shëndetit mendorë në të gjitha njësitë ka vazhduar vlerësimi intensiv psikologjik për të detektuar rastet e me vështirësi në menaxhimin e gjendjes psikologjike dhe atyre me rrezik për vetëvrasje. Ky vlerësim psikologjik po kryhet në vazhdimësi përmes baterisë së testeve zyrtare të DSHB për vlerësim psikologjik dhe inventarëve të tjera klinike sipas përzgjedhjes së psikologëve.

Tabela numër 6, paraqitja tabelore e mjeteve zyrtare për vlerësim psikologjik në burgjet e Kosovë

BATERIA ZYRTARE E TESTEVE	NË DSHB
PSIKOLOGJIKE	
FUSHA E VLERËSIMIT	MJETI MATËS
Vlerësimi fillestarë dhe i përgjithshëm i gjendjes psikologjike	Pasqyra ë Përgjithshme Psikologjike
Vlerësimi i konstrukteve dhe çrregullimeve bazë psikologjike	CORNELL INDEX
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së ankthit	BECK'S A.I
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së depresionit	BECK'S D.I

Për rastet urgjente, të cilat në bazë të interpretimit të testeve kanë treguar rrezik të moderuar apo të lartë për vetëvrasje janë dhënë rekomandimet me shkrim për secilin psikolog, bazuar në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DShB, dhe në funksion të menaxhimit të menjëhershëm të rasteve. Rastet janë vënë në menaxhim të ekipeve multidisiplinare për menaxhimin e personave me rrezik për vetëvrasje në të gjitha burgjet. Sipas kushteve të përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DShB, janë arkivuar në DSHB së bashku me raportet e vazhdueshme të punës së këtyre komisioneve.

Këtë tremujor te trete pas aplikimit të masave shtesë për parandalimin e vetëvrasjeve, janë përpunuar të dhënat lidhur me pacientët të cilët janë trajtuar për rrezik shumë të lartë për të realizuar vetëvrasje. Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar numrat e pacientëve të cilët janë trajtuar për rrezik të lartë për vetëvrasje si rezultat i tentimit për vetëvrasje ose signifikatave të larta të treguara në instrumentet psikologjike për matjen e rrezikut për vetëvrasje – në kuadër të vlerësimit sistematik - si masë shtesë.

Tabela numër 7 paraqitja tabelore e rasteve të trajtuara me rrezik të lart për vetëvrasje dhe e vetëvrasjeve të realizuara në burgjet e Kosovës gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2021.

Menaxhimi i vetëvrasjeve në burgje për gjashtëmujorin e parë 2021	Të trajtuar me rrezik të lartë për të realizuar vetëvrasje	Tentim vetëvrasjet	Vetëvrasjet të realizuara
Totali	85	10	0

Në rrethanat e krijuar nga masat kundër epidemike si përgjigje për pandeminë Covid19 me reduktim të rëndësishëm të lëvizjeve, kontakteve dhe vizitave edhe për të burgosurit, me qëllim të mbështetjes dhe ruajtjes nga dëmi shtesë i aspektit psikologjik të burgosurve në krahun psikiatrik, stafi i NjShB Dubravë ka iniciuar organizimin e terapisë së lojës. Këto forma të terapisë janë rekomanduar edhe në raportin e KPT të KE për vitin 2020.

Tani në DShB është duke u përgatitur plani i detajuar për terapinë okupuese në krahun psikiatrik të Stacionarit në NjShB të QK Dubravë. Prognozohet që deri në fund të vitit 2021 palni të jetë në zbatim të plotë.

Në kuadër të projektit të mbështetur, vite më parë, nga Ambasada Amerikane përmes ICITAP për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje, edhe përgjatë vitit 2021 stafi i shëndetit mendor në

burgje ka ofruar mbështetjen e vet profesionale dhe të vazhdueshme për komisionet multidisiplinare për derikadilizimin e të burgosurve – veçanërisht në BSL dhe QK Dubravë.

Po ashtu, dy psikolog kanë qenë pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga ICITAP lidhur me përditësimin e njohurive në çështjet e radikalizimit në burgje.

Sfidë e rëndësishme në vitin 2021 mbete numri i madh i të paraburgosurve me probleme të natyrës psikike për të cilët gjykata ka lëshuar një urdhër për vlerësim në IPFK por në mungesë të vendeve në IPFK mbahen nëpër qendrat e paraburgimit duke e mbingarkuar kështu stafin e shëndetësor në përgjithësi dhe stafin e shëndetit mendor në veçanti.

Supervizioni apo mbikëqyrja profesionale në fushat e shëndetit mendor përfaqëson procesin përmes së cilit profesionisti vazhdimisht merr shërbime personale, nga një mbikëqyrës me përvojë, me qëllim të ruajtjes së mirëqenës së vet psikologjike e cila është e cenuar vazhdueshëm nga procesi i punës me pacient me problem mendore. Mungesa e një shërbimi të tillë në nivel kombëtar ka pamundësuar një implementim të tij edhe te stafi i shëndetit mendor në burgje duke reflektuar drejtpërsëdrejti edhe në kualitetin e punës dhe mirëqenien e stafit.

Realizimi i planit sipas indikatorëve për vitin 2021 është bërë 56.36%, në proces është 32.73% dhe nuk është realizuar ende 10.91%.

Këtë raport e keni të bashkëlidhur këtij raporti.

Tabela numër 8, paraqitja e realizimit të planit sipas indikatorëve për vitin 2021;

Legjenda	1	E gjelbert	e perfunduar plotesisht	31	56.36	%
	2	E kaltert	ne proces	18	32.73	%
	3	E kuqe	e pa filluar	6	10.91	%
			Totali	55	100.00	%

Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe vështirësi të shumta, siç janë:

1. Mungesa e Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në Burgun e Dubravës si pjesë e paraparë me Ligjin për Shëndetësi.
2. Vonesat dhe pamundësitë në implementimin e rrezikshmërisë së stafit e cila do të kompensonte në një formë punën specifike dhe me presione si dhe rrezikun permanent.
3. Stafi jo i mjaftueshëm për mbulimin e të gjitha shërbimeve të domosdoshme.
4. Kemi pasur largim të stafit mjekësor nga burgjet, disa mjek, specialist dhe psikolog si rezultat i pakënaqësisë më kushtet e punës, pagën dhe mungesën e rrezikshmërisë, marrë parasysh specifikat e punës dhe natyrën e ballafaqimeve.
5. Buxheti jo i mjaftueshëm.
6. Mungesa edhe e dy autoambulancave për transportin e të burgosurve në nevojë.
7. Vështirësi të tjera në realizimin e detyrave si pasojë e integritetit të plotë në kuadër të shërbimeve të ndryshme të MSh-së dhe shpesh herë mungesë e të kuptuarit dhe përkrahjes së specifikave të punës që ka shëndetësia në burgje. Kohëve të fundit nuk kemi informata të mjaftueshme lidhur me proceset strategjike dhe legjislative të MSh-së e kjo si pasojë do të mund të krijoj vështirësi në zbatimin e tyre si dhe në mos paraqitjen real të shërbimit në këto dokumente duke mos marrë parasysh specifikat e këtij shërbimi.
8. Në funksion të transparencës së mjaftueshme, të gjitha aktivitetet i kemi publikuar në faqe të Ministrisë.

<https://msh.rks-gov.net/departamentet/departamenti-per-shendetesine-ne-burgje/>

DShB ka synime që në vazhdimësi të arrijë këto qëllime:

1. Vazhdimi i ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje dhe qëndrueshmëria e saj përmes trajnimeve, monitorimeve dhe krijimit të kushteve për shërbime cilësore.
2. Vazhdimi i krijimit të kushteve adekuate të favorshme për stafin mjekësor për punën në burgje konform UA 05/2014 dhe Rekomandimeve të Këshillit të Evropës, rregullave Evropiane të Burgjeve dhe Udhërrëfyesve të OBSH-së, përfshirë pagën e dinjitetshme, rrezikshmërinë dhe beneficione të tjera në funksion të qëndrueshmërisë së stafit në burgje.
3. Zbatimi i plotë i protokolleve, procedurave, hapësirave të punës dhe pajisjeve për punë në Njësitë shëndetësore të burgjeve konform standardeve të MSh-së dhe BE-së.
4. Vazhdimi i furnizimit të qëndrueshëm në të gjitha institucionet me barëra dhe material mjekësor.
5. Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare në të gjitha institucionet korrektuese dhe kujdesi higjienik e sanitar i përhershëm përmes DDD dhe formave tjera higjienike si dhe ngritjen e njohurive mbi rëndësinë e higjienës personale në burgje.
6. Themelimin e Institucionit për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta
7. Bashkëpunimi dhe trajnimi specifik i organeve monitoruese të shërbimeve shëndetësore në burgje përmes trajnimit adekuat, profilizimit dhe ndikimit në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.
8. Rritjen e bashkëpunimit me shërbimet e tjera të MSh-së në funksion të integritetit të plotë të shërbimeve në kuadër të sistemit shëndetësor publik. Tejkalimi i neglizhencave dhe arritjen e synimit që shërbimet e MSh-së të kuptojnë më shumë specifikat dhe rëndësinë e plotësisë të shërbimeve shëndetësore në burgje përmes mbështetjes së vazhdueshme në çdo sferë.
9. Vazhdimi i përpjekjeve për ndryshimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Kosovës në funksion të disa plotësimit ndryshimeve dhe futjen e këtyre çështjeve siç janë; inkompatibiliteti për burg, ndërprerja e dënimit për shkaqe shëndetësore dhe limitimi i moshës për kryerje të dënimit.

Në vazhdimësi do të jemi transparent lidhur me gjendjen shëndetësore të të burgosurve dhe aktivitete e ndërmarra, bazuar në planin e punës dhe PSV-të për trajtimin shëndetësor të të burgosurve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt!